



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Miratohet

Kryetari

Muzafer KORKUTI

RREGULLORE

*Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare
të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
për mënyrën e organizimit të konkurseve;
për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre*

(Aprovuar me Urdhërin Nr. 11 datë 6 tetor 2016)

Tiranë 2016



Pjesa I

DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim *themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare*, si dhe mënyrën e zhvillimit të konkurseve që shpallen, organizohen dhe jepen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), mbështetur në Ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 4, *Funksionet e Akademisë së Shkencave*, pika dh: *organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore*.

1.2 Në këtë rregullore përcaktohen fushat përparësore për të cilat themelohen çmimet vjetore kombëtare të ASHSH; kriteret dhe procedurat për organizimin e konkurseve; mënyra e krijimit dhe struktura e përbërja e jurive; kushtet e pranimit, të përzgjedhjes, të vlerësimit dhe të shpalljes së fituesve.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1.** *Ligj* është Ligji nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, i ndryshuar.
- 2.** *Çmime shkencore* janë çmimet që jep ASHSH.
- 3.** *Konkurse* janë kompeticionet shkencore që organizon ASHSH.
- 4.** *Fushat e kërkimit shkencor* janë disiplinat / nëndisiplinat ku zhvillohet kërkimi shkencor.
- 5.** *Botim shkencor / projekt shkencor / patentë shkencore* janë vepra shkencore monografike të publikuara / të regjistruara, që sintetizojnë rezultate origjinale të kërkimit shkencor dhe përmbajnë zgjidhje të certifikuara.
- 6.** *Nominim* është procesi i përzgjedhjes parapërfundimtare të jo më pak se tri kandidaturave për secilin nga çmimet shkencore kombëtare.
- 7.** *Laureat* është çdonjëri prej fituesve të çmimeve dhe konkurseve shkencore kombëtare.



8. *AKTI* është Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Informacionit.
9. *MTI* është Ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit.
10. *KKU* është Komisioni Kombëtar i UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.
11. *AIESEE* është Komisioni Kombëtar i *Association Internationale d'Etudes du Sud-Est Europeen*, që funksionon pranë ASHSH.
12. *IAP* është lidhja globale e shkencës e njohur me emrin *InterAcademy Partnership: The Global Network of Science Academies*.
13. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në Vendimin nr. 2, datë 1 korrik 2014, *Për miratimin e kriterëve për botim në Akademinë e Shkencave*.

Pjesa II

QËLLIMI DHE KOHA E ORGANIZIMIT

Neni 3

3.1 Çmimet shkencore kombëtare vjetore të ASHSH themelohen me qëllim që:

- a. Të mbështeten dhe vlerësohen *studime dhe kërkime shkencore origjinale*, në përputhje me përparësitë themelore të kërkimit shkencor akademik dhe universitar, në funksion të zhvillimit shoqëror, ekonomik e kulturor të vendit.
- b. Të nxitet konkurrenca dhe të identifikohet *cilësia shkencore* e arritjeve më të shquara në kërkim, shkencë, inovacion, të autorëve nga Shqipëria / autorëve shqiptarë / nga gjithë bota etj., që dallohen për origjinalitet, nivel të lartë krijimtarije, pavarësi tezash e mendimi, rëndësi dhe pranim ndërkombëtar.
- c. Të orientohen *kërkime shkencore në fusha dhe disiplina që kanë të bëjnë me çështje që diktohen* prej zhvillimit të përgjithshëm të vendit.
- d. Të mundësohet *përdallimi i studiuesve të rinj më rezultativë*, me kërkesa për cilësi shkencore dhe kërkim origjinal; të nxitet ndërveprimi dhe vijimësia midis brezave të kërkuesve.
- e. Të vlerësohen meritat jetësore shkencore të personaliteteve dhe karriera e suksesshme akademike e kërkuesve shkencorë të shkallës së *ekscelencës*.
- f. Të nxitet kërkimi institucional, prej shkallës së njësisë bazë të kërkimit shkencor; të çmohet dhe rivlerësohet tradita e punës në grup, me karakter ndërdisiplinar.



3.2 Konkursset shkencore organizohen me qëllim që:

- g.** T'u jepen zgjidhje konkrete problematikave të zhvillimit të vendit, që kërkojnë domosdoshmërisht ekspertizën e kërkimit shkencor.
- gj.** Të funksionojnë efektivisht urat e komunikimit ndërmjet vendimmarrjes politike dhe shkencës për çështje zhvillimore që duhet të asistohen prej kërkimit shkencor.
- h.** Të përurohen e të mbështeten kërkimet përparësore me ndikim të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm në zhvillimin shkencor, shoqëror e ekonomik të vendit.

Neni 4

Koha e organizimit të çmimeve shkencore

1. Çmimet shkencore kombëtare të ASH janë *të përvitshme*.
2. Shpallja e procedurave, afateve, kriterëve dhe mënyrës së organizimit të çmimeve shkencore kombëtare bëhet me këtë rregullore dhe me akte që rrjedhin prej saj, me vendim të Kryesisë së ASHSH.
3. Regjistri i çmimeve mbahet dhe administrohet pranë Kryesisë së ASH-së.

Neni 5

Koha e organizimit të konkurseve shkencore

1. ASHSH, në pajtim me përparësitë kryesore funksionale të saj dhe me kërkesat për inkurajim shkencor që dalin prej zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, organizon sipas rastit konkurse shkencore kombëtare.
2. Shpallja e konkurseve kombëtare, tematika e tyre dhe kriteret e organizimit, bëhen me propozim të seksioneve shkencore të ASHSH dhe konfirmohen me vendime të Kryesisë së ASHSH.
3. Regjistri i konkurseve mbahet dhe administrohet pranë Kryesisë së ASH-së.



Pjesa III

LLOJET E ÇMIMEVE SHKENCORE DHE KRITERET E ORGANIZIMIT

Neni 6

Çmimi shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike

1. Çmimi shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike jepet për botime, projekte dhe për arritje të shquara akademike-universitare, që u takojnë fushave kërkimore përparësore të shkencave shoqërore-albanologjike.
2. Çmimi mban emrin *Eqrem Çabej*.
3. Shpërblimi financiar për këtë çmim parashihet në buxhetin e ASHSH dhe shprehet në urdhrin e shpalljes së fituesit, pas dhënies së vendimit të jurisë.
4. Fituesi i çmimit gëzon të drejtën e shenjës së tij dhe të diplomës, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës.

Neni 7

Çmimi shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave natyrore-teknike

1. Çmimi shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave natyrore-teknike jepet për botime, projekte dhe për arritje të shquara akademike-universitare që u takojnë fushave kërkimore përparësore të shkencave natyrore-teknike.
2. Çmimi mban emrin *Petrit Radovicka*.
3. Shpërblimi financiar për këtë çmim parashihet në buxhetin e ASHSH dhe shprehet në urdhrin e shpalljes së fituesit, pas dhënies së vendimit të jurisë.
4. Fituesi i çmimit gëzon të drejtën e shenjës së tij dhe të diplomës, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës.

Neni 8

Çmimi shkencor kombëtar vjetor i karrierës akademike

1. Çmimi shkencor kombëtar vjetor i karrierës akademike jepet për *merita shkencore të vijueshme me rëndësi për dijet kombëtare*, për personalitete të shkencës kombëtare, në shenjë nderimi për kontributet e tyre gjatë jetës krijuese.
2. Konkurrenti për këtë çmim mund të jetë fitues vetëm një herë.



3. Shpërblimi financiar për këtë çmim parashihet në buxhetin e ASHSH dhe shprehet në urdhrin e shpalljes së fituesit, pas dhënies së vendimit të jurisë.
4. Fituesi i çmimit gëzon të drejtën e shenjës së tij dhe të diplomës, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës.

Neni 9

Çmimi shkencor kombëtar vjetor për kërkuesin e ri më të suksesshëm

1. Çmimi vjetor për kërkuesin e ri më të suksesshëm, që jepet nga juria për shkencëtarin e ri më të vlerësuar prej saj, përzgjidhet midis konkurruesve me rezultatet më të shquara në shkollat universitare të doktoratës e në kërkimet e pavarura.
2. Konkurrenti për këtë çmim mund të jetë fitues vetëm një herë.
3. Shpërblimi financiar për këtë çmim parashihet në buxhetin e ASHSH dhe shprehet në urdhrin e shpalljes së fituesit, pas dhënies së vendimit të jurisë.
4. Fituesi i çmimit gëzon të drejtën e shenjës së tij dhe të diplomës, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës.

Neni 10

Pjesëmarrësit

Në konkurset vjetore për çmimet shkencore kombëtare vjetore që ASHSH jep për vepra të shquara shkencore mund të marrin pjesë:

1. Studiues nga Republika e Shqipërisë, nga gjithë hapësira historike shqiptare dhe nga diaspora.
2. Albanologë e shkencëtarë të huaj, me veprimtari të shquar aktive në shkencën shqiptare.
3. Kandidatët mund të propozohen nga institucionet kërkimore-shkencore ku kryejnë veprimtarinë e tyre, nga botuesit dhe shoqata ku janë të anëtarësuar. Kandidatët mund dhe të vetëpropozohen.
4. Për vepra me karakter institucional, propozues e pjesëmarrës mund të jenë njësitë themelore të kërkimit shkencor akademik e universitar (departamente, qendra e institute kërkimore shkencore), të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në sistemin kombëtar të kërkimit shkencor në vend.
5. Kandidimet pranohen për vepra me një autor dhe me shumë autorë, për vepra vetjake e institucionale. Në rastin e shpalljes fitues të një vepre shumautorëshe, shpërblimi i çmimit të fituar ndahet mes tyre.



Neni 11

Kriteret e organizimit

1. Çmimet shkencore kombëtare jepen nga ASHSH për botime monografike / projekte kërkimore / patenta shkencore të regjistruara, me vlera shkencore të shquara e origjinale.
2. Shpallja e çmimeve vjetore bëhet me *thirrje për pjesëmarrje* në faqen zyrtare të ASHSH dhe së paku *në tri medie kombëtare*.
3. Me përjashtim të herës së parë, në çmimet kombëtare shkencore që jepen nga ASHSH pranohen vetëm vepra (botime, projekte kërkimore dhe patenta shkencore të regjistruara), me karakter origjinal, që i përkasin *vitit paraardhës*.
4. Me përjashtim të herës së parë, periudha e shprehjes së interesit për pjesëmarrje fillon nga 1 qershori i çdo viti dhe përfundon më 31 dhjetor.
5. Juria shpall listën e *plotë të konkurrentëve* të propozuar dhe/ose të vetëpropozuar jo më vonë se dyjavëshi i parë i muajit janar të vitit pasardhës.
6. Juria përzgjedh nga numri i përgjithshëm i kandidatëve jo më shumë se 3 (tre) prej tyre për t'i shpallur të nominuar për çdo çmim. Nominimi njoftohet publikisht nga juria jo më vonë se dyjavëshi i parë i muajit shkurt të vitit pasardhës.
6. Shpallja e laureatëve fitues të çmimeve vjetore kombëtare bëhet me një ceremoni të posaçme solemne publike të organizuar nga ASHSH brenda muajit mars të vitit kalendarik vijues.

Neni 12

Certifikimi i pjesëmarrjes

Kandidati i vetëpropozuar ose i propozuar nga një qendër kërkimore, shoqatë studiuesish apo ent botues; si dhe institucionet e kandiduara për vepra shumautorëshe, duhet të paraqesin zyrtarisht pranë zyrës së protokollit të ASHSH:

1. Kërkesën e motivuar për pjesëmarrje.
2. Curriculum vitae.
3. Listën e bashkautorëve dhe/ose përbërjen e redaksisë (për veprat me shumë autorë dhe nismat shkencore institucionale).
4. Dy kopje të pakthyeshme të studimit / projektit të botuar. Në përfundim të konkursit botimet hyjnë në inventarin e bibliotekës shkencore të ASHSH.
5. Certifikatën e regjistrimit të patentës; dëshminë e autoritetit miratues të projektit.
6. Deklaratën e autorësisë dhe të origjinalitetit të punës kërkimore shkencore/patentë.
7. Një përmbledhje analitike në gjuhën angleze për studimin e paraqitur për konkurrim.



8. Deklaratën për pranimin e kushteve të konkurrimit siç parashikohet në këtë rregullore.

9. Pjesëmarrësit në konkurs paraqesin një arsytim të motivuar për rëndësinë e kërkimit shkencor të kryer dhe faktorët përse vepra e tyre duhet të jetë fituese e çmimit/çmimeve kombëtar/e vjetor/e të shpallura nga ASHSH.

10. Dy rekomandime mbështetëse për veprën e kandidatit konkurrues prej institucioneve të specializuara kërkimore akademike-universitare janë të mirëpritura.

11. Kur çmimi i akordohet një institucioni, ai depoziton gjithashtu: aktin e themelimit, statutin, kopje të dokumentit si person ligjor, një deklaram të pranimit të çmimit.

Pjesa IV

JURIA, FORMIMI DHE PËRBËRJA; PËRGJEGJËSITË E SAJ DHE SHPALLJA E FITUESVE

Neni 13

Përbërja e jurisë

1. Juria formohet me këtë përbërje:

Kryetar : *Një përfaqësues i Kryesisë së ASH.*

Anëtar : *Një përfaqësues i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike me titullin "Akademik".*

Anëtar : *Një përfaqësues i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike me titullin "Akademik".*

Anëtar : *Dy përfaqësues të seksioneve gjegjëse të Asamblesë së ASHSH.*

Anëtar : *Një përfaqësues i akademikëve mbi 75 vjeç.*

Anëtar : *Një përfaqësues i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.*

Anëtar : *Një përfaqësues i Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit.*

Anëtar : *Dy përfaqësues prej rrjetit të universiteteve shqiptare me titullin "Profesor"; gjegjësisht nga shkencat shoqërore dhe ato teknike-natyrore*

Anëtar: *Një përfaqësues nga IPA.*

Anëtar : *Një përfaqësues i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.*

Anëtar : *Një përfaqësues i Komisionit Kombëtar të AIESEE.*



2. Anëtarët e jurisë që përfaqësojnë institucione, caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë.
3. Anëtarët e jurisë nuk mund të konkurrojnë për çmimet kombëtare shkencore.
4. Përbërja nominale e jurisë shpallet me urdhër të Kryetarit të ASHSH.
5. Juria formohet për një edicion të vetëm për çmimet kombëtare që jepen nga ASHSH (për një vit).
6. ASHSH krijon kushtet e nevojshme të punës për ushtrimin normal të përgjegjësive të jurisë.
7. Juria ka sekretarinë e vet shkencore, e cila mban procesverbalet e mbledhjeve dhe të procedurave që kryhen prej saj. Në funksionin e sekretarit shkencor caktohet një punonjës i sektorit të botimeve dhe bibliotekës shkencore të ASHSH.
8. Vlerësimi i kandidatave bazohet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe në parametrat bazë të *ekscelencës*.
9. Juria ka të drejtën e një shpërblimi për punën e saj.

Neni 14

Përgjegjësitë e jurisë

1. Përgjegjësitë dhe detyrat e jurisë caktohen me këtë rregullore dhe me urdhër të posaçëm të Kryetarit të ASHSH.
2. Juria zhvillon takime e diskutime deri në shpalljen e vendimit. Vendimi përfundimtar i jurisë, që përmban emrat e fituesve të çmimeve, nënshkruar nga anëtarët e saj, shpallet me urdhër të Kryetarit të ASHSH.
3. Juria është autonome në vendimmarrje. Vendimet e jurisë merren me votim të fshehtë. Vota pakicë nuk e komenton publikisht vendimin e vet.
4. Diskutimet në juri mbeten konfidenciale. Kryetari i jurisë mund të paraqitet me komente për shtypin me autorizimin e saj.

Neni 15

Fituesit e çmimeve

Fituesve të çmimeve vjetore kombëtare të ASHSH u jepen:

1. Diploma si fitues të çmimit kombëtar të ASHSH, e cila nënshkruhet nga kryetari i jurisë dhe Kryetari i ASHSH. Diploma përmban emrin e fituesit, motivacionin, titullin e çmimit, nënshkrimet e autoritetit vendimmarrës dhe numrin e amzës.
2. Shenjën e çmimit të fituar dhe shpërblimin financiar të parashikuar.



3. Dhënia e çmimeve bëhet përmes një ceremonie solemne e publike të organizuar nga ASHSH.

Neni 16

Revokimi i çmimeve

1. Çmimet mund të revokohen kur provohet se është shkelur etika e kërkimit shkencor dhe nuk janë respektuar të drejtat e autorit e ato intelektuale të palëve të treta.

Neni 17

Amendimet

1. Kjo rregullore mund të amendohet me vendim të Kryesisë së ASHSH, me propozim të seksioneve shkencore të saj ose të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë.

Neni 18

Të fundme

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të ASHSH.

Tiranë, më 6 tetor 2016

